

por Feka me kushërinjtë Skënderin dhe Hysniun kanë mbetur në pozicionet e veta deri në orët e mbrëmjes, kur edhe ata u nisën drejt Tushilës/Tušilje. Te vendi i quajtur *Ara e Shaban Batallit/Njiva Shabana Batallija* [Rakinicë/Rakitnica] ata u ndeshën me pjesëtarë të forcave serbe. Gjatë shkëmbimit të zjarrit, Fekën e kanë qëlluar për vdekje, përderisa Skënderi dhe Hysniu kanë arritur që të largoheshin pa lëndime. Pas dy ditësh, kur situata u qetësua për një kohë të shkurtër, bashkëluftëtarët e Fekës shkuan dhe e morën trupin e tij. E kanë varrosur në varrezat e fshatit, ku prehet edhe sot.

Burimet: deklarata I.D, FDH-32468; J. Martin-sen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Avdyli (Latif) Smajli

(14.11.1963, shqiptar nga Kuçica/Kučica, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Avdyli jetonte në bashkësi familjare me bashkëshorten Haven dhe tre djem të mitur. Në muajin qershor të vitit 1998, ai shkoi në Shqipëri për transportimin e armatimeve. Në ndërkohë, familjarët e tij e kanë braktisur fshatin dhe kurrë më nuk e kishin takuar. Në datën **11.07.1998**, Avdyli ka rënë gjatë luftimeve me forcat serbe në pyll, që i takon fshatit të **Klinës së Epërme/Gornja Klina**, në afërsi të rrugës Mitrovicë/Kosovska Mitrovica – Pejë/Peć, te kthesa për në Skënderaj/Srbica. E kanë varrosur po atë ditë në varrezat e fshatit të lindjes.

Burimet: deklarata B.S, FDH-32796; J. Martin-sen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Hasan (Jashar) Jashari

(1912, shqiptar nga Likoci/Likovac, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, tre fëmijë)

Në datën **16.07.1998**, forcat serbe kanë hyrë në **Likoc/Likovac**. Banorët e fshatit largoheshin me vrap nga shtëpitë e veta duke u strehuar në pyll. Hasani nuk deshë ta braktiste shtëpinë. Një muaj më vonë, kur forcat serbe u larguan nga fshati, shqiptarët u kthyen dhe në rrugë që çon drejt fshatit e kanë gjetur trupin e Hasanit. E njohën në bazë të rrobave. E kanë varro-

sur në afërsi të vendit ku e kanë gjetur. Pas lufte, familjarët e kanë riarrosur Hasanin më 14.04.2000 në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata J.B, FDH-13962; KMDL NJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 153, FDH-23857.

Vjollca (Niman) Avdyli

(9.06.1985, shqiptare nga Vojnika/Voćnjak, komuna e Skënderajt/Srbica, nxënëse)

Fshati Vojnikë/Voćnjak u bombardua më **16.07.1998**. Vendasit u zhvendosën në pyll përmbi fshat [Vojnikë/Voćnjak]. Vjollca me familjarët u strehuan nën lisat e pyllit. Për një çast, një predhë ka rënë në afërsi të vendit ku gjendej ajo. Një cifël e granatës e ka qëlluar Vjollcën. Ishte e plagosur rëndë. Bombardimi ka zgjatur tërë ditën. Kur pushoi, babai i Vjollcës e ka çuar atë në fshatin Izbicë/Izbica, ku ndihmën e parë i dha mjeku Zaim Bajraktari. Ai konstatoi se vajza duhej t'i nënshtrohej intervenimit kirurgjikal, por prindërit nuk kishin guxim ta çonin në spitalin serb. Ajo ndërroi jetë pas pesë javësh. Prindërit e kanë varrosur në varrezat e lagjes *Turijan*, në fshatin Vojnikë/Voćnjak.

Burimet: deklarata N.A, FDH-40632; J. Osmani, *Krimet...*, II, 290.

Tahir (Brahim) Hasani

(1.03.1927, shqiptar nga Klina e Poshtme/Donja Klina, komuna e Skënderajt/Srbica, mullis, pesë fëmijë)

Tahiri i moshëthyer me bashkëshorten Shefkijen dhe familjen e djalit Emnit jetonin në fshatin Klinë e Poshtme/Donja Klina. Në muajin qershor të vitit 1998, forcat e shumta serbe kanë ardhur nga drejtimi i Mitrovicës/Kosovska Mitrovica dhe i kanë marrë pozicionet në udhëkryqin e fshatit të Klinës së Mesme/Srednja Klina. Shumica e banorëve e kanë braktisur fshatin. Emni e ka çuar bashkëshorten dhe fëmijët në Rezallë/Rezala dhe menjëherë u kthye në shtëpi, ku kanë mbetur prindërit e tij dhe djali Albani, 14 vjeç [Klinë e Poshtme/Donja Klina]. Tri ditë më vonë, më **20.07.1998**, forcat serbe erdhën te shtëpia e tyre. Të gjithë u larguan, përveç Tahirit.